



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr.177/21**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “EL-BAU”-sh.p.k Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Urban” O.P -Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë” me nr. të prokurimit: VU644-20-6595-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Vushtrri”, më datën: 23.03.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “EL-BAU”-sh.p.k Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë” me nr. të prokurimit: VU644-20-6595-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Vushtrri”.
- II. ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë” me nr. të prokurimit: VU644-20-6595-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Vushtrri”, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.
- III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "EL-BAU"-sh.p.k Gjilan, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik "EL-BAU"-sh.p.k Gjilan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.02.2021 me nr. 177/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë" me nr. të prokurimit VU644-20-6595-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK Vushtrri", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: Neni 1 par.1 dhe 2, neni 6, neni 7 par.1,2 dhe 4, neni 51 par. 1, neni 56 par.1.1 dhe 1.2, neni 59 par. 4 , neni 60 par1. Neni par.1.1, neni 61 par.1, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.02.2021, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 08.03.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

### SQARIM HYRËS

Eksperti shqyrtues bazuar në rregulloren e punës së OSHP-së neni 16. paragrafi 2 ku thotë:

(2) Eksperti i njëjtë shqyrtues, nëse konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar më parë nga paneli shqyrtues, e njofton panelin shqyrtues lidhur me këto pretendime ankimore.

Me tej eksperti shqyrtues sqaron se pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me çmimet jo-normalisht të ulëta janë shqyrtuar në Raport ekspertizën me nr. 1166/20, dhe në vendimin e OSHP-së me nr. 1166/20, të datës 28.01.2021, andaj eksperti shqyrtues jep përgjigjeje vetëm për pretendimet ankimore



për të cilat nuk janë shqyrtuar në raport ekspertizë dhe në vendimin e OSHP-së të lartë përmendur.

#### Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues është se me datë 19.02.2021 ne kemi qenë në qasje në dokumente për të parë çfarë ka ndodhur pas vendimit të OSHP-së, ku në vendimin e tyre është cekur se OE "URBAN O.P" ishte cekur se ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe çmime nën tarifën e KRM UNITETI, por AK përsëri ka përdorur standarde të dyfishta më qëllim që OE "URBAN O.P" të jetë përsëri fitues.

Më datë 08.02.2021 ka vendosur fillimisht që ta trajtoi tenderin e Juaj në mesin e tenderëve të përgjegjshëm, dhe në rast rekomandimi për dhënie të kontratës të rritë Garancionin e Sigurimit të Ekzekutimit të Kontratës në masën 30% të çmimit të përgjithshëm të vlerës së parashikuar të kontratës. Ndërsa me datë 09.02.2021 OE "URBAN O.P 2 iu është përgjigjur AK-së më një shkresë ku thuhet se më këtë shkresë ju njoftojmë se kemi pranuar kërkesën e juaj lidhur me tenderin " Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale më infrastrukturë " me nr. prok. 644-20-083-521 dhe pajtohëmi me atë që nese na jipët puna ne të rrisim vlerën e garancionit të sigurimit të ekzekutimit të kontratës në masë 30% të çmimit të përgjithshëm të vlerës së parashikuar të kontratës.

Pra AK Komuna e Vushtrrisë edhe pse është kontestuar me vendimin e OSHP-së 1166/20 i datës 28.01.2021 se OE "URBAN O.P " ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta nën tarifën e KRM UNITETI, AK shpall fitues përsëri "OE URBAN O.P "dhe me këtë rrezikon ekzekutimin e kontratës dhe njëkohësisht rrezikon edhe lumenjtë dhe hapësirat e gjelbërta sepse shihet hapur se OE në fjalë nuk ka asnjë mundësi apo llogari që ta kryej një shërbim të tillë me një çmim prej 3.50 për ton ndërsa në deponin e KRM UNITETI të paguaj çmimin prej 60.00 euro për ton për deponinë e tyre. Pra nga kjo që u cek më lartë shihet se AK nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së ku ceket si në vijim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lendes, shqyrtimit të pretendimeve të OE ankues , konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK në këtë aktivitet të prokurimit nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE. Po ashtu AK nuk ka pasur parasysh rregullat për tenderin jo-normalisht të ulët ku me rastin e vlerësimit nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që ti zbatoj të gjithat dispozitat e LPP-së me rastin e rivlerësimit , duke zbatuar rregullat për tenderin jo-normalisht të ulët, si dhe të veproj në harmoni me më të gjitha pikat e nenit 59 të LPP-së.

AK në rastin konkret gjatë vlerësimit të tenderëve kundrejt OE fitues dhe OE tjerë të lartcekur është dashur që ta zbatoj procedurën e shqyrtimit (inter partes) në pajtim me nenin 61 të LPP-së dhe ta refuzojë tenderin e OE fitues si dhe tenderët e OE-ve tjerë të cekur si tender me çmime jo-normalisht të ulët.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lëndë LPP-në, RRUOPP-në dhe në vendimin e Panelit shqyrtues me nr. 1166/20 te datës 28.01.2021 sqaron se PSH citoj: Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK në këtë aktivitet të prokurimit nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE. Po ashtu AK nuk ka pasur parasyshë rregullat për tenderin jo-normalisht të ulët ku me rastin e vlerësimit nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që ti zbatoj të gjithat dispozitat e LPP-së me rastin e rivlerësimit , duke zbatuar rregullat për tenderin jo-normalisht të ulët, si dhe të veproj në harmoni me më të gjitha pikat e nenit 59 të LPP-së.

Në vazhdim eksperti shqyrtues sqaron se AK ne përgjigjeje ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE "URBAN O.P "ka cekur se duke qenë se kontrata për këtë aktivitet të prokurimit është kontratë kornizë, se sasi të artikujve dhe/ ose shërbimeve indikativë qe janë parashikuar të blihen përmes këtij aktiviteti të prokurimit nuk kanë qenë te ditura për A.K. AK, bazuar edhe ne njohuritë paraprake të tija gjatë një periudhe të gjatë kohore nuk ka pasur fare blerje të shërbimeve të tilla të specifikuara në pikën E nënpika 2 " Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponine regjionale të menaxhuar nga UNITETI " dhe nënpika 3 " Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore dhe jo ushqimore (mbetjet e asgjësimit ) si dhe mbeturinat shtazore ,deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI " andaj, bazuar në nenin 28,të RRUOPP ka vlerësuar se frekuenca dhe rëndësia e artikujve gjegjësisht shërbimeve të cituara si më lartë në këtë vendim është e një rëndësie shumë më të ulët andaj ka vendosur që ta zgjedhe ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët të peshuar.

Me tej eksperti shqyrtues sqaron se AK në platformën e e-prokurimit ka ngarkuar B41 ku bazuar ne nenin 30 siguria e ekzekutimit paragrafi 4 të RRUOPP-se ka kërkuar rritjen e ekzekutimit të kontratës, neni 30.4 i RRUOPP-së thotë:

30.4 Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën **10% të vlerës së kontratës**. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, AK do të siguroj që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Autoriteti kontraktues, pasi që të jetë përputhur me nenin 61 te LPP-se, ka mjaft arsye për të besuar se operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht te ulet), gëzon te drejtën qe përqindjen e kërkuar te sigurimit te ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata.

AK ka kërkuar nga operatorët Ekonomik **citoj**: Bazuar në këtë vlerësim, për të qenë më shumë bindës dhe për tu siguruar ne si A.K. se Kontrata do të përmbushet në mënyrë të pranueshme si në aspektin cilësor e profesional ashtu dhe në aspektin sasior, A.K. ka vendosur fillimisht që ta trajtoi tenderin e



Juaj në mesin e tenderëve të përgjegjshëm, dhe në rast rekomandimi për dhënie të kontratës të rritë Garancionin e Sigurimit të Ekzekutimit të Kontratës në masën 30% të çmimi të përgjithshëm të vlerës së parashikuar të kontratës.

OE URBAN O.P me datë 09.02.2021 ngarkon në platformën e e-prokurimit shkresës **citoj**: në pajtohemi me atë që nëse na jepet puna ne, të rrisim garancionin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në masën 30% të çmimit të përgjithshëm të vlerës së parashikuar të kontratës. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat në lëndë konstaton se AK Vushtrri nuk ka zbatuar në përpikëri neni 61 të LPP-së, dhe rregullat për tenderin jo-normalisht të ulët pasi që nuk ka kërkuar një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë, por AK duke u bazuar në periudhat paraprake duke ditur rendësin e blerjeve të këtyre shërbimeve ka vlerësuar që mjafton të kërkojë nga OE të rris garancionin e sigurimit të ekzekutimit. Andaj bazuar në sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet **si pjesërisht e bazuar**, dhe rekomandon që të mbetet në **fuqi Njoftimi mbi vendimin e AK-së**.

Raporti i ekspertizës me datën 08.03.2021

Autoriteti kontraktues me datë 12.03.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues. pajtohemi me Mendimin e Eksperti Shqyrtues të paraqitura në raport. A.K mbetemi në tersi pranë vlerësimit të tone dhe se ndajm mendimin se vlerësimi ynë ka qenë i drejtë dhe i bazuar në dispozitat perkates ligjore të LPP-së.

Në do të mbesim në pritje deri në Vendimin e drejtë përfundimtar që do ta marr OSHP.

Po ashtu kërkojmë që brenda mundësive ky aktivitet të trajtohet me urgjencë për shkak të rëndësës që ka për qytetaret e Komunës tone sepse tani po hymë në stinën ku kemi nevojë shumë për intervenime të tilla cafre janë të parapara në këtë aktivitet.

Operatori ekonomik me datë 15.03.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Lënda: Përgjigje në Raportin e Ekspertit Shqyrtues Nr.177/21

**Titulli i aktivitetit:** “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë” me numër VU644-20-6595-5-2-1

Ne kemi pranuar Raportin e Ekspertit Shqyrtues Nr. 177/21 të dt. 08.03.2021 në lidhje me çështjet e parashtruara në ankesën e OE "El-Bau" në OSHP kundrejt vendimit të AK- Vushtrri për dhënien e kontratës OE "URBAN O.B".

Pas vlerësimit dhe analizimit të raportit, e njoftojmë Panelin Shqyrtues se **NUK PAJTOHEMI** me vlerësimin e ekspertit shqyrtues Es'heme Beka andaj kërkojmë që kjo çështje të shqyrtohet dhe vendoset nga ana e panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Arsyet e mospajtit me vlerësimin e Raportit të Ekspertit Shqyrtues qëndrojnë në shkaqet dhe rrethanat si në vijim:

Eksperti shqyrtues nuk është përgjigjur/nuk ka vlerësuar pretendimet ankimore që janë ngritur nga ana e OE ankues përkundër se vendimi i AK-së ka prodhuar pasoja juridike për ankuesin. Arsyeimi i ekspertit shqyrtues është se keto pretendime janë shqyrtuar në ekspertizën 1166/20 dhe nga Paneli Shqyrtues në Vendimin e OSHP-se me Nr. 1166/20 të dt. 28.01.2020. Raporti i ekspertit shqyrtues në tërësi është vetëm përshkrim i çështjeve të parashtruara në ankesë si dhe përshkrim i disa veprimeve proceurale të AK-së që i ka ndërmarrë pas ri-vlerësimit.

Por në anën tjetër askund nuk e ka konstatuar se AK gjatë ri-vlerësimit nuk e ka zbatuar Vendimin e Panelit Shqyrtues me nr. 1166/20 nuk ka marrë asnjërin nga veprimet ligjore dhe korrigjuese të rekomanduara për ta rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me dispozitat e LPP-së. Mirëpo duke rënë në kundërtënie me vlerësimin e tij paraprak si dhe me vlerësimin e tanishëm se AK-ja nuk e ka zbatuar nenin 61 të LPP-së dhe rregullat për tenderë jo-normalisht të ulët, çuditërisht rekomandon që të mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimin e AK-së, dhënien e kontratës OE në fjalë që me vendim të OSHP-së është vlerësuar si i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues siç e ka detyrë dhe përgjegjësi ligjore nga neni 114 i LPP-së, nga një analizë e mirëfilltë dhe e detajuar bazuar mbi dokumentacionin e tenderit, akteve të AK-së dhe vendimit të OSHP-së, ka mundur që të identifikojë dhe konstatojë të gjitha shkeljet thelbësore ligjore që kanë ndodhur gjatë këtij aktiviteti si pasojë e veprimeve të paligjshme dhe vlerësimeve selektive e subjektive të AK-së.

Shkeljet e AK-së gjatë ri-vlerësimit dhe nxjerrjes së vendimit të kontestuar qëndrojnë në arsyet dhe shkaqet si në vijim:

Nuk e ka zbatuar Vendimin e OSHP-së PSH.nr. 1166/20 të dt. 28.01.2021

Paneli Shqyrtues në Vendimin PSH.nr. 1166/20 të dt. 28.01.2020, duke shqyrtuar pretendimin paraprak kundrejt vendimit të kontestuar të AK-së për dhënien e kontratës OE "URBAN O.P", në mënyrë të qartë kishte konstatuar se "Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në llogaritjet e bëra për pozicionet, ku OE ankues pretendon se janë ab-normalisht të ultë, konstaton se tek pozicioni nr. 1,2,3 dhe 4, OE i rekomanduar për kontratë ka sjellë çmim jo-normalisht të ulët, dhe si



rrjedhojë OE i rekomanduar për kontratë konsiderohet si ofertë ab-normal i ulët në pozicionin në fjalë”.

Vendimet e marra nga ana e OSHP-së lidhur me pretendimet në ankesë janë plotësisht të detyrueshme dhe menjëherë ekzekutive për palët. Secila prej këtyre palëve, duke përfshirë edhe autoritetet kontraktuese, duhet të respektojnë dhe zbatojnë vendimet e marra nga OSHP-ja brenda afateve dhe kushteve të parashikuara në LPP. Nëse pala mendon se vendimi përfundimtar ose konstatimi i një vendimi të panelit shqyrtues është në kundërshtim me faktet ose me këtë ligj siç ka konstatuar AK në vendimin e dt. 25.02.2021 ku ka konstatuar “..andaj dhe rezultati i nxjerrë në vendimin e OSHP-së mund të jetë i pasaktë dhe jo ligjërishit i drejtë”, ka të drejtë që të ushtrojë ankesë pranë gjykatës kompetente për t’i kërkuar shqyrtimin dhe anulimin e vendimit.

Pra në rastin konkret, siç e dëshmon vendimi i nxjerrë gjatë ri-vlerësimit dhe vendimi i dt. 25.02.2020 me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE “El-Bau”, AK – Komuna e Vushtrrisë ka shfaqur pakënaqësi ndaj vendimit të OSHP-së mirëpo të njëjtin nuk e ka ankimuar në gjykatën kompetente, ndërsa në anën tjetër të njëjtin nuk e ka zbatuar duke mos marrë për bazë konstatimet dhe urdhëratë që iu janë dhënë për të korigjuar shkeljen e pretenduar dhe parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të parashtruesit të ankesës.

Kontratën ia ka ri-dhënë OE të papërgjegjshëm në kundërshtim me kriteret e vendosura në nenin 60 si dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 61 të LPP-së dhe Rregullores për Tender Jo-Normalisht të Ulët Lidhur me aktivitetin konkret bazuar në dosjen e tenderit – FTD 30.1 kriter për dhënien e kontratës është **Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Ndërsa në Aneksin 6 të dosjes kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar **Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të peshuar**. Në formë tabelore janë përcaktuar: gjashtë (6) kategori, (A,B, C, D, E, F), përshkrimi i punëve dhe pesha (rëndësia) e çmimeve e secilës kategori në %.

Bazuar në dokumentacionin e lëndës gjegjësisht Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 09.12.2020 ( Letra Standarde për Eing – Com) nxirret në pah analiza financiare që AK e ka nxjerrë nga hulumtimi i tregut sipas të cilës për secilin pozicion/njësi matëse të paramasës është nxjerrë çmimi referent nga hulumtimi i tregut duke i shtuar edhe TVSH-në.

Meqenëse në rastin konkret objekt kontesti kundrejt OE “Urban O.B.” janë çmimet manipulative në pozicionet që përfshijnë përshkrimin e punëve/shërbimeve që hynë në kategorinë E ( pozicioni 1, 3 dhe 4) , po paraqesim faktet nga të cilat mund vërehet se si AK ka shkelur parimin e barazisë dhe parimin e objektivitetit duke mbajtur dhënien e kontratës tek OE i papërgjegjshëm.

**1. Analiza financiare e AK-së sipas hulumtimit të tregut për pozicionin E – Nr. 3; çmimi i ofertuar nga OE “URBAN O.B”, dhe dallimi nën çmimin referent**

Në këtë pozicion është planifikuar që të kryhen punët: **ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore dhe jo ushqimore (mbetje e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore deri në deponinë regjionale të menagjuar nga UNITETI.**

Sipas analizës financiare dhe hulumtimit të tregut nga AK për këtë pozicion është nxjerr çmimi referent me TVSH 60€/ton.

Çmimi i paraqitur sipas analizës financiare të AK-së është konform tarifës publike të caktuar nga Deponia URBAN.

OE fitues "Urban O.B." për këtë pozicion ka paraqitur **çmimin 3.5€/ton**

Sipas krahasimit të çmimit referent të AK-së 60€/ton me çmimin e ofertuar të OE fitues 3.5€/ton, rezulton se OE në fjalë për pozicionin në fjalë ka ofertuar 56.5€/ton apo 16 herë më lirë nën çmimin referent të analizës financiare së AK-së dhe çmimit publik tarifor të KRM UNITETI.

## **2. Analiza financiare e AK-së sipas hulumtimit të tregut për pozicionin E – Nr. 4; çmimi i ofertuar nga OE "URBAN O.B", dhe dallimi nën çmimin referent**

Në këtë pozicion është planifikuar që të kryhen punët: "Dislokimi i shtyllave ekzistuese të drurit dhe zavendesimi i tyre me shtylla të betonit me lartësi H=9 m këndore tip 40° me bazament të betonit duke përfshirë gërmimin për baament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m vendosjen e betonit, shiritin e tokëzimit Fe/Zn 25x4 mm (3.5m) reren e imet, montimi i sërishëm i kabllave ekzistuese ajrore dhe nëntokësore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshëm komplet me ateste për një shtyllë të dislokuar".

Sipas analizës financiare dhe hulumtimit të tregut nga AK për këtë pozicion është nxjerrur **çmimi referent me TVSH 50€/ton.**

Çmimi i paraqitur sipas analizës financiare të AK-së është konform tarifës publike të caktuar nga Deponia UNITETI

OE fitues "Urban O.B." për këtë pozicion ka paraqitur **çmimin 5€/ton**

Sipas krahasimit të çmimit referent të AK-së 50€/ton me çmimin e ofertuar të OE fitues 45€/ton, rezulton se OE në fjalë për pozicionin në fjalë ka ofertuar 45€/ton apo 9 herë më lirë nën çmimin referent të analizës së AK-së dhe çmimit publik tarifor të Deponisë UNITETI.

I njëjti krahasim analitik vlen edhe për pozicionet tjera në të cilat OE në fjalë ka ofertuar me çmime krahasueshëm shumë më të ulta se sa çmimet reale dhe referente të tregut.

Ndërsa karrshi OE tjerë për të njëjtën çështje përdor standarde të dyfishta të vlerësimit – refuzuese duke i vlerësuar si çmime jo normalisht të ulëta

Andaj në rastin konkret duke u bazuar në faktet e lartëcekura OE "URBAN O.B." me çmimet e ofertuara për pozicionet në fjalë ka plotësuar në tërësi kushtet e nenit 61 të LPP-së që tenderi i tij të vlerësohet si tender i papërgjegjshëm bazuar në çmimin jo-normalisht të ulët të ofruar deri në 16 herë më të ulët se çmimi referent sipas analizës financiare të tregut të bërë nga AK si dhe sipas çmimit



publik tarifor të KRM UNITETI. Dhe për më tepër këto janë çmime të pabesueshme/manipulative me qëllim të përfitimit të kunderligjshëm të tenderit dhe në anën tjetër për t'i shkaktuar dëm AK dhe interesit publik.

Për këtë arsye, vendimi i AK-së për mbajtjen e dhënies së kontratës tek OE në fjalë, është vendim i padrejtë dhe i paligjshëm mbi bazën e shkeljeve të dispozitave thelbësore të LPP-së nga neni 1, neni 6, neni 7, neni 56 par. 1.2, neni 60 par.1.1, neni 61 pasi që i njëjti është i karakterizuar me konsiderata/interesa personale, me një shkallë të lartë të diskriminimit ndaj OE ankues dhe anasjelltas favorizimit ndaj OE fitues, dhe i cili nuk përmban përmbledhje faktike mbi fakte vendimtare dhe bazë ligjore mbi të cilat bazohet vendimi.

Sa i përket justifikimit të AK-së se pse ka vendosur që ta zgjedh ofertën e OE fitues, me arsyetimin se shërbimet e punëve të specifikuar në kategorinë "E" pozicioni 2 dhe pozicioni 3 (pozicione ku OE fitues ka ofertuar me çmime deri në 16 herë më të ulët se çmimi referent i tregut i verifikuar nga vet AK dhe çmimorja publike e KRM UNITETI) se frekuenca dhe rëndësia e këtyre shërbimeve është e një rëndësie shumë më të ulët, nuk qëndron në mënyrën e paraqitur, por është e kundërta. Kjo mënyrë paraqet dëshirën e AK-së dhe jo kërkesën ligjore dhe të dosjes së tenderit.

E vërteta është se në dosjen e tenderit përkatësisht Anexin 6, në tabelën që përfshinë gjashtë kategori nga A deri në F, kategoria E sipas peshës (rëndësisë) së çmimeve është peshuar/poentuar me 20% me maximumin e kategorive paralel me kategorinë C dhe D pasi kategoritë tjera janë peshuar me 10%.

Sa i përket kërkesës së AK-së drejtuar OE OE "URBAN O.B." për rritjen e Garancionit të Ekzekutimit të Kontratës nga 10% në masën 30% të çmimit të përgjithshëm të vlerës së parashikuar të kontratës, kjo është një kërkesë tërësisht jo e ligjshme edhe sipas dispozitës në të cilën thirret AK, dhe kërkesa si e tillë ka për qëllim të favorizimit për ta mbajtur dhënien e kontratës me çdo kusht dhe në çdo rrethanë tek OE "URBAN O.B."

Gjatë ciklit të fazës së planifikimit të prokurimit, AK në bazë të vlerësimit formal të nevojave dhe rezultateve të lëndës që planifikon ta prokurojë ndër tjera duhet të marrë masa edhe për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e parametrave të rrezikut për përfundimin me sukses dhe efektiv të lëndës së prokuruar. Dhe konform këtyre masave të përcaktojë edhe kërkesat ligjore sa i përket mekanizmit të sigurisë së ekzekutimit të kontratës në zgjedhjen e tenderuesit të suksesshëm që do ta implementojë kontratën në në koston, kohën dhe cilësinë e parashikuar pa i shkaktuar humbje AK. Pra sipas kërkesave ligjore nga neni 63 të LPP-së lidhur me nenin 30 të RRUOPP, siguria e ekzekutimit është një instrument ligjor që i kërkohet OE si parakusht për nënshkrim dhe hyrje në fuqi të kontratës për të eliminuar rrezikun nga shkelja e kontratës dhe dëmet që mund t'i shkaktohen AK-së. Sigurimi i ekzekutimit arrin qëllimin e sigurisë dhe është i zbatueshëm nëse është i nevojshëm dhe në përputhje me LPP.

Në këtë rast, AK-ja sipas vlerësimit të vet bazuar në parametrat e rrezikut që i ka identifikuar dhe analizuar, në dosjen e tenderit pika 14.2 ka vendosur kërkesën formale që shuma e sigurisë së ekzekutimit të kontratës të jetë 10 % (dhjetë përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Kërkesa e AK-së kundrejt OE të favorizuar për rritjen e sigurisë së ekzekutimit nga 10% në 30%, fillimisht është në kundërshtim me vet kërkesën e vendosur në pikën 14.2 të dosjes së tenderit – FTD, është kërkesë në kundërshtim me qëllimin e dispozitës ligjore të nenit 63 të LPP-së përkthësisht 30 të RRUOPP të cilën e ka parafrazuar pa asnjë mbështetje dhe arsye relevante. Prandaj në rastin konkret nuk ekziston asnjë rrethanë e parashikuar nga paragrafi 3 i nenit 63 të LPP-së për faktin se tenderuesi në fjalë është i papërgjegjshëm vërtetuar edhe me vendim të plotfuqishëm të OSHP-së. AK-ja në mënyrë të qëllim të tenton të hyjë në kontratë me një OE të papërgjegjshëm për të cilin qysh tani dihet që kontrata është e dështuar dhe nuk mund të përmbushet.

Në anën tjetër AK-ja për çështjen e njëjtë karrshi OE tjerë të cilët kanë shprehur gatishmëri për ta rritur sigurinë e ekzekutimit, përdor standard mohues/refuzues duke konstatuar se AK nuk ka siguri se Ju do ta përmbushni kontratën me sukses përkundër rritjes së sigurimit të ekzekutimit të kontratës, punimet si dhe artikujt e porositur nuk do të jenë cilësorë dhe në përshtatshmëri të dëshiruar dhe/ose kërkuar.

Prandaj nga të gjitha këto fakte dhe sqarime që u paraqitën, shihet se vendimi i AK-së është i ndikuar, i karakterizuar me diskriminim ndaj OE ankues dhe anasjelltas favorizim karrshi OE fitues. AK-ja nuk ka për qëllim që ta ndal gabimin këtu por ta vazhdoj tutje për ta mbrojtur interesin e OE fitues në kundërshtim me kërkesat ligjore, në kundërshtim me vendimin e OSHP-së të cilin nuk e ka zbatuar.

Për këto arsye të paraqitura më lartë, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së të aprovohet në tërësi e bazuar ankesa e OE ankues dhe Urdhëroje AK ta vazhdoj procesin e ri-vlerësimit duke ndërmarr veprime korrigjuese në zbatim të vendimit të OSHP-së dhe konform dispozitave ligjore të LPP-së

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.03.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të ankesës së OE ankues “EL-BAU”-sh.p.k Gjilan, sqaron se pretendimit ankimor ka të bëjë me mos zbatimin e vendimit të OSHP-së pasi në vendim ishte cekur se



OE "URBAN O.P" ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe çmime nën tarifën e KRM UNITETI, por AK përsëri ka përdorur standarde të dyfishta më qëllim që OE "URBAN O.P" të jetë përsëri fitues. Paneli Shqyrtues për këtë pretendim ankimor sqaron se AK me datë 08.02.2021 i është drejtuar OE të rekomanduar duke i sqaruar se ka vendosur që ta trajtoj tenderin e OE të rekomanduar në mesin e tenderëve të përgjegjshëm, dhe në rast rekomandimi për dhënie të kontratës të rritë garancinë e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në masën 30% të çmimi të përgjithshëm të vlerës së parashikuar të kontratës. Ndërsa me datë 09.02.2021 OE "URBAN O.P 2 i është përgjigjur AK-së më një shkresë, ku thuhet se më këtë shkresë ju njoftojmë se kemi pranuar kërkesën e juaj lidhur me tenderin "Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale më infrastrukturë " me nr. prok. 644-20-083-521 dhe pajtohemi me atë që nëse na jepet puna ne të rrisim vlerën e garancionit të sigurimit të ekzekutimit të kontratës në masë 30% të çmimit të përgjithshëm të vlerës së parashikuar të kontratës.

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh konstatimet në vendimin paraprak Psh.Nr.1166/20 të datës 28.01.2021, ku është konstatuar:

"Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në llogaritjet e bëra për pozicionet, ku OE ankues pretendon se janë ab-normalisht të ultë, konstaton se tek pozicioni nr.1,2,3 dhe 4, OE i rekomanduar për kontratë ka sjellë çmim jo-normalisht të ulët, dhe si rrjedhojë OE i rekomanduar për kontratë konsiderohet si ofertë ab-normal e ulet në pozicion në fjalë. Prandaj bazuar në sqarimet që u dhanë më lartë del ky pretendim ankimor është i bazuar."

Po ashtu, duke pasur parasysh se OE i rekomanduar "URBAN O.P" ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta nën tarifën e KRM UNITETI, konkretisht duke ofruar me një çmim prej 3.50 për ton ndërsa në deponinë e KRM UNITETI të paguaj çmimin prej 60.00 euro për ton për deponinë e tyre, Paneli Shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimor është u bazuar. Për më tepër, Paneli Shqyrtues sqaron se në vendimin paraprak janë dhënë udhëzime për autoritetin kontraktues, ku është konstatuar:

"Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK në këtë aktivitet të prokurimit nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE. Po ashtu AK nuk ka pasur parasyshë rregullat për tenderin jo-normalisht të ulët ku me rastin e vlerësimit nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që ti zbatoj të gjithat dispozitat e LPP-së me rastin e rivlerësimit , duke zbatuar rregullat për tenderin jo-normalisht të ulët, si dhe të veproj në harmoni me më të gjitha pikat e nenit 59 të LPP-së."

Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar vendimin paraprak dhe nuk ka pasur parasysh çmimet e ofruara nga OE ankues të cilat janë nën tarifën e përcaktuara të deponisë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete, deklaramit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimi dhe ekzaminimit të tenderëve nuk ka pasur parasysh çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar të cilat janë nën tarifat e deponisë. Andaj, obligohet AK të marrë parasysh konstatimet në këtë vendim dhe të bëjë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni të plotë me dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK "KK Vushtrri";
- 1x1 OE "EL-BAU sh.p.k";
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.